



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:217196
Datë: 12.11.2021
Numri i dokumentit: 02390623

PPP.nr.101/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, e përbërë nga gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, në lëndën përmbarese të kreditorit K. E. e K. (KEK) SH:A., Rr.Nëna Terezë, nr.36,10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, nr.i regjistrimit të kompanisë nr.70325399; Nr. TVSH330051805, kundër debitorit I. (H.) S. nga Rahoveci me adresë ... Xh. H. T. - Rahovec, me numër personal ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin të përmbaresit privat Gjokë Radi në Gjakovë, me të cilin është caktuar përmbarimi P.nr.336/19, prej datës 25.06.2019, më 12.11.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **REFUZOHET** prapësimi i debitorit **I. (H.) S.** nga Rahoveci, i paraqitur kundër urdhrin të përmbaresit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit **K. E. e K. (KEK)**, lidhur me kthimin e borxhin në shumën prej **1.003.00 euro**.
- II. Urdhri i përmbaresit privat Gjokë Radi, P.nr.336/19, prej datës 25.06.2019, me të cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit, lidhur me kthimin e borxhit, në shumën prej 1.003.00 euro, me kamatë ligjore 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit me datë 25.06.2019, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarese, **MBETËT NË FUQI**.
- III. Ankesa kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën përmbarese, përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.

A r s y e t i m

Në bazë të propozimit të kreditorit K. E. e K. (KEK), përmbaresi privat Gjokë Radi, me urdhrin P.nr.336/19, prej datës 25.06.2019 ka caktuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstrakt nga librat afarist nga data 06.10.2009 deri me 20.03.2013, lidhur me kthimin e borxhin në shumën prej 1.003.00 euro.

Kundër urdhrorit me të cilin është caktuar përmbartimi, debitori ka paraqitur prapësim me të cilin ka kontestuar urdhrin për caktimin e përmbartimit, me pretendim se ka arritur parashkrimi lidhur me borxhin e lartcekur.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimi të kreditorit, urdhrorit për lejimin e përmbartimit, prapësimi të debitorit dhe shkresave tjera që gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe i njëjti është refuzuar. Lidhur me pretendimin e debitorit, se ka parashkrim absolut, gjykata e muri si të pa bazuar sepse debitori I. (H.) S. me datën 02.09.2016 ka nënshkruar kontratë për pagimin e borxhit dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-043 për faljen e Borxheve Publike dhe i njëjti nuk i është përmbajtur kësaj marrëveshje dhe gjykatës nuk i ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën.

Ndërsa kreditori propozimit për përmbartim ja ka bashkangjitur kontratën për pagesën e borxhit dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit të nënshkruara me datën 02.09.2016, me të cilën është pajtuar debitori I. S., për kthimin e borxhin.

Kështu që gjykata, vendosi që ta refuzoi prapësimin e debitorit, e duke u bazuar në nenin 22 par.1 nën par.1.1 të LPP-së, ku ndër të tjera është cekur: *Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji*, ndër të tjera, *është edhe fatura*, e po ashtu në paragrafin 3 të këtij neni është cekur: *Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.*

Andaj gjykata, ka ardhur në përfundim se pretendimet e debitorit të cekura në prapsim, nuk janë bazë e mjaftueshme, e as pengesë për lejimin e përmbartimit në rastin konkret, lidhur me propozimin e kreditorit.

Nga të lartcekurat, kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 73 par.1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi procedurën përmbartimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
PPP.nr.101/2019, më 12.11.2021

B. Profesional
Afrim Gashi

G j y q t a r i
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.